

Për: Shkelqësinë e Tij Fatmir Sejdiu, Kryetar i Kosovës

Nga: Delegacioni i Koalicionit Ndërkombëtar për Dinjitetin Njerëzor për Kosovën (International Coalition for Human Dignity delegation to Kosovo), Susan Yoshihara, Ph.D., Kryetare, Grupi i Organizatave për Hulumtime Ndërkombëtare (International Organizations Research Group (IORG)), New York, e-mail: i fshirë.

Lënda: Mbrojtja e Sovranitetit të Kosovës sipas Traktateve të KB për të Drejtat e Njeriut

Domosdoshmëria e mbrojtjes së sovranitetit: Kosova si shtet i ri i pavarur së shpejti do të bëhet palë e traktateve ndërkombëtare siç obligohet në kushtetutën e saj të re dhe do të përgatis raporte periodike për organet e traktateve të KB për të drejtat e njeriut. Para disa viteve, këto komitete më të madhe i kanë tejkaluar autorizimet e tyre dhe i kanë detyruar shtetet e pavarura në çështje të ndryshme kundërthënëse që nuk kërkohen me traktate. Për shkak se komitetet veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk kanë asnjë mekanizëm formal mbikëqyrës të palës së Shtetit, ato në esencë nuk jepin përgjegjësi. Për më tepër, për shkak se anëtarët e komitetit shpesh herë janë nga organizatat jo-qeveritare (OJQ), kontrollat periodike janë bërë vendtakime ku shtetet e pavarura i raportojnë OJQ-ve. Për shembull, afër gjysma e 23 anëtarëve të komitetit të Konventës për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) përbëhet nga OJQ-të që i përkrahin fuqishëm të drejtat për liberalizimin e abortit, edhe pse traktati hesht ndaj abortit. Palët shtetërore kanë interes për të siguruar se sovranitetin e tyre nuk humbet nga organet e traktateve duke e qartësuar në mënyrë formale dhe të qëndrueshme qëllimin origjinal dhe kuptimin e traktateve.

Domosdoshmëria e mbrojtjes kundër presioneve për t'i ndryshuar qëndrimet rreth jetës së familjes. Organet e traktateve të KB për të drejtat e njeriut në mënyrë rutinore i keqinterpretojnë traktatet të cilat u janë besuar për t'i mbikëqyrur, dhe u bëjnë presion palëve Shtetërore për t'i ndryshuar politikat dhe praktikat që më kujdes janë lënë jashtë traktateve nga ana e Shteteve që i kanë negociuar ato. Për shembull, sipas Human Rights Watch, komiteti CEDAW u ka bërë presion shteteve për ta legalizuar prostitucionin, e ka kritikuar Uzbekistanin për nderimin e rolit fisnik të amësisë, e ka qortuar Kroacinë për mbrojtjen e të drejtave të mjekëve për të mos marr pjesë në abort, dhe i ka detyruar më shumë se 93 palë Shtetërore në 122 raste për t'i liberalizuar ligjet e tyre të abortit.

Zgjedhja e politikave. Sipas Seksionit të Traktatit të Zyrës së KB për Çështjeve Ligjore (UN Treaty Section Office of Legal Affairs (UN treaty office – Zyra e KB për Traktate)), pala Shtetërore zakonisht i dorëzon vërejtjet/rezervat ose sqarimet për qëndrimin ndaj traktatit në kohën e ratifikimit. Zyra e traktatit e merr vendimin nëse ato duhet të qarkullohen, dhe nëse komunikimi do të qarkullohet si vërejtje në përputhje me Koventën e Vjenës të vitit 1969. Palët tjera shtetërore kanë një periudhë kohore për t'i kundërshtuar vërejtjet. Në këtë rast nuk kërkohet vërejtja meqenëse traktatet heshtin ndaj këtyre çështjeve morale. Në të kundërtën, një sqarim i

qëndrimin është i nevojshëm meqenëse ai është lëndë për ta qartësuar kuptimin origjinal të konventës. Një deklaratë e tillë duhet të jetë “e veçantë, e qartë, dhe e kapshme” ashtu që palët tjera Shtetërore ta kuptojnë marrëdhënien e saj në raport me traktatin, dhe nuk duhet të heq ose shtoj ndonjë obligim.

Rekomandim. Dorëzoni deklaratat për interpretim në kohën e nënshkrimit të traktateve ndërkombëtare që e mbrojnë Kosovën nga shkelja e të drejtës së saj sovrane për t’i mbrojtur të drejtat e dinjitetit njerëzor dhe familjes. Deklaratat e propozuara për disa traktate janë si më poshtë.

Deklaratat e propozuara [CEDAW]:

“Qeveria e Kosovës e kupton se asgjë në Konventën për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave paraqet përkrahje për abortin, legalizimin e abortit, komoditetet ose modalitetet e shoqëruara me abortin.” [duke u bazuar në deklaratën e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara e bërë me rastin e miratimit të traktatit të KB për personat me aftësi të kufizuara në Asamblenë e Përgjithshme të KB, dhjetor 2006.]

“Qeveria e Kosovës e kupton se asgjë në Konventën për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave paraqet përkrahje për prostitucionin ose dekriminalizimin e prostitucionit, që rrezikon dinjitetin e femrës dhe nxitë tragjedinë e trafikimit të qënieve njerëzore, prej të cilëve gratë dhe fëmijët janë viktima kryesore.”

Deklaratat e propozuara [ICCPR]:

“Qeveria e Kosovës e kupton se asgjë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Politike [International Covenant on Civil and Political Rights] paraqet përkrahje për abortin, legalizimin e abortit, komoditetet ose modalitetet e shoqëruara me abortin.”

“Qeveria e Kosovës e kupton se asgjë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Qytetare dhe Politike paraqet përkrahje ose sanksionim ligjor për martesën e seksit të njëjtë ose akteve seksuale që e cenojnë dinjitetin e personit njerëzor.”

Deklarata e propozuar [CRC]

“Qeveria e Kosovës e kupton se asgjë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës [International Covenant on the Rights of the Child] i rrezikon të drejtat natyrale të prindërve dhe familjes, e cila është njësisia bazë e shoqërisë sipas Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.”